



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 24.27.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR
TË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i Ekipit Jusuf Kryeziu, dhe Anëtarët e Ekipit Arta Birinxhiku dhe Nora Rashiti, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymberi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	18
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	19
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	22
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	23

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 29/11/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Institucionit të Avokatit të Popullit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar


Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Avokatin e Popullit, dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Avokatit të Popullit - auditimi 2016**

Avokati i Popullit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Drejtori i Përgjithshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Avokati i Popullit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

IAP, kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në MF, mund të konsiderohet e plotë dhe e saktë në të gjitha aspektet materiale, andaj ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur lidhur me PFV-të.

Po ashtu, në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PVF-të.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për IAP-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetëtori i vet-vlerësimit që plotësohet nga IAP siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në IAP në lidhje me raportimin menaxherial dhe llogaridhënien pasqyron një situatë pozitive. Megjithatë edhe me tutje janë të nevojshme të behën përmirësime. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm ishte mjaft i ulët. Më tej IAP, nuk ka përgatitur raportin e menaxhimit të rrezikut, i cili do të identifikojë rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj, si dhe nuk kishte arritur të sigurojë ndarje adekuate të detyrave dhe përgjegjësi.

Në anën tjetër, Njësia e Auditimit të Brendshëm në vazhdimësi tregon një cilësi të lartë të punës përmes së cilës jep vlerësime të qëndrueshme lidhur me funksionimin e kontrolleve në organizatë. Në këtë aspekt, përfitimi nga puna e auditimit të brendshëm duhet të merret në konsideratë nga menaxhmenti i IAP-së për përmirësimin e fushave me mangësi të theksuara.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2015, ka rezultuar me katër (4) rekomandime. IAP ka përgatitur një Plan Veprimi për të siguruar se të gjitha rekomandimet zbatohen brenda periudhës së specifikuar.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, dy (2) rekomandime janë në proces të zbatimit, përderisa dy (2) nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë zbatuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura	Menaxhmenti i IAP-së nuk ka ndërmarrë masa të duhura për zbatimin e plotë të rekomandimeve të vitit paraprak (2015). Rekomandimet e pazbatuara ndërlidhen më zhvillimin e planit vjetor të organizatës, menaxhimin e rrezikut si dhe plotësimin e pozitës së ZKF-së.
Rreziku	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë me mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve dhe vështirësi në përmbushjen e objektivave.
Rekomandimi 1	Avokati i Popullit duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për këtë. Për rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësit të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuar në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësit.

Ne kemi përmbledhur konkluzionet tona për IAP-në të cilat se bashku me të gjeturat dhe konkluzionet e nxjerra në auditimet tjera do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 - Lista kontrolluese e vet-vlerësimit - Prioritet i lartë

- E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë (5) komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi vërejtur se:
- IAP në fund të vitit 2016, ka arritur të hartoj strategjinë dhe planin zhvillimor të saj, mirëpo nuk kishte hartuar planin vjetor të punës, për të mundësuar më pas përqendrimin në arritjen e rezultateve të planifikuara; dhe
 - Nuk kishte të hartuar regjistrin për menaxhimin e rrezikut i cili duhet t'i paraprinte procesit të identifikimit të rreziqeve dhe vlerësimit të tyre me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve në nivel të pranueshëm.
- Rreziku** Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara. Mos hartimi i planit vjetor të punës, rrit rrezikun që të punësuarit e IAP-së dhe akterët tjerë të mos orientohen/punojnë drejtë qëllimeve të përbashkëta dhe drejt rezultateve të synuara.
- Rekomandimi 2** Avokati i Popullit duhet të sigurojë se është rishikuar procesi i plotësimit të pyetësorit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit IAP operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Procesi i raportimit të brendshëm funksionon sipas zingjirit llogaridhënës në përputhje me ligjin dhe strukturën organizative. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta me të gjitha departamentet dhe njësitë e saj. Megjithatë ne identifikuam çështjen si në vijim.

Çështja 3 – Zyrtari Kryesor Financiar – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas Ligjit të Financave Publike dhe Përgjegjësiive kërkon që “Çdo Organizatë Buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet ta ketë Zyrtarin Kryesor Financiar”.
- IAP në strukturën e tyre administrative, nuk e kishin të plotësuar këtë pozitë. Për plotësimin e kësaj pozite ne rekomanduam edhe në vitin paraprak, mirëpo edhe përkundër zotimit të menaxhmentit për plotësimin e saj, ende kjo pozitë ka mbetur e paplotësuar.
- Rreziku** Mungesa e Zyrtarit Kryesor Financiar paraqet një zbrazëti në sistemin e kontrollit të brendshëm, si dhe në mungesë të tij ekziston rreziku që pasqyrat financiare të përmbajnë gabime materiale.
- Rekomandimi 3** Avokati i Popullit duhet të sigurojnë një strukturë organizative në të cilën ekziston një ndarje e duhur e detyrave dhe përgjegjësiive, si dhe një linjë e qartë e raportimit dhe llogaridhënies. Në këtë aspekt në periudhën sa më të shkurtë kohore të ndërmarrë veprimet e duhura për plotësimin e pozitës së Zyrtarit Kryesor Financiar.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një anëtarë - Drejtori i NjAB. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të IAP-së dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve.

Kjo njësi për vitin 2016 ka planifikuar gjashtë (6) auditime, të cilat janë kryer deri në përfundim të vitit 2016. Vlerësimi ynë është se raportet e NjAB-së janë cilësore dhe menaxhmentit i kanë ofruar pasqyrë të qartë mbi nivelin e funksionimit të kontrolleve të brendshme, si dhe janë dhënë rekomandime konkrete për përmirësim të mëtutjeshëm.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

IAP në përgjithësi ka kontrollë të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të procesit buxhetor marrë si tërësi janë të mira. IAP ka arritur të realizoj po thuaj në tërësi buxhetin final për vitin 2016.

Auditimi ynë i këtij viti nuk ka identifikuar ndonjë mangësi domethënëse në menaxhimin e përgjithshëm të shpenzimeve, më përjashtim të disa çështjeve në mallra dhe shërbime.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për IAP-në dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	980,071	1,036,964	1,013,391	882,383	819,206
Granti i Qeverisë -Buxheti	980,071	996,390	991,662	882,383	819,206
Donacionet e jashtme	-	40,574	21,729	-	-

Buxheti final në raport buxhetin fillestar ishte rritë për 56,893€. Kryesisht, ky ndryshim i atribuohet rritjes së buxhetit nga rishikimi i buxhetit në vlerë prej 422,148€, shkurtimeve buxhetore me vendim të Qeverisë në vlerë prej 405,829€ si dhe përfshirjes së donacioneve prej 40,574€.

Në vitin 2016, IAP ka përdorur rreth 98% të buxhetit, me një përmirësim për 3% në raport me vitin paraprak (në vitin 2015 ishte realizuar rreth 95%).

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	980,071	1,036,964	1,013,391	882,383	819,206
Pagat dhe Mëditjet	625,560	623,477	618,207	601,535	542,558
Mallrat dhe Shërbimet	329,011	340,295	324,720	268,897	252,779
Shërbimet komunale	25,500	22,992	20,264	11,951	14,724
Investimet Kapitale	-	50,200	50,200	-	9,145

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 2083€. Fillimisht buxheti ishte rritur për 294,806€ për punësimin e stafit të ri, dhe 27,000€ për vlerën e donacionit nga Këshilli i Evropës. Megjithatë për shkak të mos punësimit, buxheti i pashpenzuar prej 323,888€ ishte reduktuar me vendim të Qeverisë në fund të vitit. Buxheti final për këtë kategori është shpenzuar mbi 99%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshinë edhe vlerën e donacionit nga Qeveria Turke, Belge dhe Norvegjeze në vlerë 13,574€, të cilat nuk janë shpenzuar në vitin 2016. Buxheti final për këtë kategori në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 11,284€ (me rishikim është rritur për 61,342€ ndërsa në atë final është zvogëluar me vendim të Qeverisë për 50,058€). Buxheti final për mallra dhe shërbime është shpenzuar mbi 95%;
- Buxheti final për komunal në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 2,508€, si rezultat i vendimit të Qeverisë. Buxheti final është shpenzuar rreth 88%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin e rishikuar është zvogëluar për 15,800€ me vendim të Qeverisë. Buxheti për këtë kategori është shpenzuar rreth 100%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe në këtë proces kanë dëshmuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në PFV-të e IAP-së. Në këtë kategori ishin shpenzuar mbi 99% të buxhetit final (ref: tabela nr.2). Ne kemi ekzaminuar disa mostra dhe kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë. Bazuar në testet tona konkludojmë se IAP kishte vendosur kontrolleve efektive në menaxhimin e tyre.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 363,287€. Prej tyre ishin shpenzuar 344,984€. Ato kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime 324,720€ dhe shpenzime komunale 20,264€. Në këtë kategori ishin shpenzuar mbi 95% të buxhetit final (ref: tabela nr.2). Ne kemi ekzaminuar disa mostra dhe kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë, dhe si rezultat i ekzaminimit identifikuam mangësitë në vijim.

Çështja 4 – Mangësi në realizimin e shpenzimeve - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër-bleerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa në fjalë.

Në pagesën "Furnizime për zyrë" me vlerë 3,607€, zotimi dhe urdhër blerja janë lëshuar pas pranimit të faturave. Faturat ishin pranuar me datë 10.05.2016 dhe 16.05.2016, ndërsa zotimi është bërë më datë 18.05.2016 dhe urdhërblerja është lëshuar me datë 24.05.2016.

Gjithashtu në gjashtë raste të tjera kemi vërejtur që urdhërblerja është lëshuar pas pranimit të faturave, për pagesat si: "Mobilje" në vlerë 11,891€; "Furnizim me ushqim dhe pije" në vlerë 102€; "Shërbime kontraktuese tjera" në vlerë 4,600€; "Furnizim për zyrë" 5,066€, "Shërbime kontraktuese tjera" prej 3,190€ dhe "Botimet e publikimeve" prej 10,855€.

Rreziku Pranimi i mallra dhe shërbime para se të përcaktohen kërkesat/ nevojat, mund të rezultojë që të pranohen mallrat të cilësisë dhe sasisë jo të nevojshme. Gjithashtu dhe pranimi i faturave pa siguruar fondet e nevojshme mund të rezultojë në vonesa në ekzekutimin e pagesave si dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për muajt vijues.

Rekomandimi 4 Avokati i Popullit duhet të forcoj kontrollet në realizimin e shpenzimeve dhe të siguroj pajtueshmëri të plotë me hapat e përcaktuara me LMFPP-në dhe me rregullat e Thesarit.

Çështja 5 - Pagesa e stafit për përkrahje dhe motivim - Prioritet i lartë

E gjetura Sipas nenit 11 pika 5 të Ligjit Nr.05/L-071 për buxhetin e vitit 2016, shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve “Mallra e shërbime” nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve në formë të dhuratave.

IAP më qëllim të përkrahjes dhe motivimit të stafit për shkak të angazhimeve të shtuara në fund të vitit lidhur me akomodimin në objektin e ri, ka paguar nga 100€ për stafin e saj. Pagesa në vlerë totale 4,600€ ishte bërë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve (në kodin ekonomik 13460, shërbime kontraktuese tjera). Realizimi i këtij shpenzimi ka shkaktuar edhe keq klasifikimin e informatave financiare.

Rreziku Realizimi i shpenzimeve në këtë mënyrë, përveç së është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi njëkohësisht e rrit rrezikun e menaxhimit jo racional të parave publike dhe prezantimit të besueshëm në pasqyra financiare.

Rekomandimi 5 Avokati i Popullit duhet të përmirësoj nivelin e kontroleve në realizimin e shpenzimeve dhe të sigurojë se shpenzimi i parave publike bëhet në përputhje me ligjin e buxhetit dhe ligjin për menaxhimin e financave publike dhe nuk do lejohen pagesa në formë dhuratave nga kategoria mallra dhe shërbime.

3.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 50,200€. Gjithashtu dhe shpenzimi për këtë kategori ishte 50,200€, ku janë blerë dy automjete dhe tri fotokopje nga IAP në vitin 2016. Për ekzaminimin e tyre kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë. Nga ekzaminimi i tyre ne nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për ta theksuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurive jo financiare kapitale (mbi 1,000€) e paraqitur në PFV ishte 61,154€, vlera e pasurive jo kapitale (nën 1,000€) ishte 46,743€, ndërsa vlera e stokeve 41,609€. Ne kemi ekzaminuar disa mostra në këtë kategori, si dhe kemi kryer një ekzaminim fizik të pasurisë për të verifikuar ekzistencën e tyre. Ne nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi në menaxhimin e tyre.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Obligimet e papaguara

IAP, ka shpalosur obligimet e papaguara në PVF për vitin 2016 në përputhje me Rregullën Financiare nr. 02/2013/MF për Raportimin e Obligimeve të Papaguara të Organizatave Buxhetore.

Vlera e obligimeve të shpalosura ishte 4,058€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. IAP ka treguar progres në menaxhimin e faturave të papaguara, përderisa obligimet ishin rënë për 1,906€ në raport me vitin paraprak (në fund të vitit 2015 obligimet e papaguara ishin 5,964€).

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Avokati i Popullit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:


- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.4 Pyetësi i vet-vlerësimit të MFK-së	Avokati i Popullit duhet të sigurojë se është përgatitur një strategji gjithëpërfshirëse zhvillimore e organizatës, si dhe është zbatuar një rishikim për plotësimin e pyetësit të vetvlerësimit në mënyrë që adresimi i fushave me dobësi të bëhet në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikimit për ta konfirmuar saktësinë e përgjigjeve të dhëna në pyetësinë e vetvlerësimit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Në fund të vitit 2016 është hartuar strategjia zhvillimore e organizatës, mirëpo nuk është bërë planifikim vjetor i organizatës, si dhe nuk janë ndërmarr hapat e duhur në drejtim të identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve.	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Avokati i Popullit duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.			Nuk janë marrë masa.
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Avokati i Popullit në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm duhet të sigurojnë një strukturë organizative në të cilën ekziston një ndarje e duhur e detyrave dhe përgjegjësive, si dhe një linjë e qartë e raportimit dhe llogaridhënies. Në këtë aspekt në periudhën sa më të shkurtë kohore të plotësohet pozita e ZKF-së.			Nuk janë marrë veprime.
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Avokati i Popullit duhet të vazhdojë përpjekjet që në bashkëpunim me MAP-in të sigurojë se listat e pagave (payroll) janë të përgatitura në pajtueshmëri me Akt emërimet për secilin të punësuar, përfshirë pozitën dhe koeficientin e pagesës.		IAP ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar këtë dukuri (shkresat e drejtuara te Ministria e Administratës Publike për dy vite rresht).	

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Prishtinë,
8 qershor 2017

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, ju njoftoj dhe konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Parapakisht, ju faleminderit për mirëkuptim dhe bashkëpunimin tuaj.

Me nderime,

Jashar Kastrati,
Sekretar i Përgjithshëm, Institucioni i Avokatit të Popullit.